

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Shkurt, 2019**

Drejtorja e përgjithshme e EI-së për Evropën qëndroi në Kosovë
Vizitë domethënëse dhe shumë e suksesshme



Duke realizuar turneun e vizitave në katër shtete të Ballkanit e për të shprehur nga afër përkrahjen e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, ka qëndruar dy ditë edhe në Kosovë, drejtorja e përgjithshme e Internacionales Botërore të Arsimit për Evropën, znj. Suzan Flocken dhe është takuar me udhëheqësit sindikalë të SBASHK-ut dhe përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Kosovës... (faqe 4)

Këshilli Drejtues në takimin e jashtëzakonshëm solli vendim



Orët e humbura në grevë nuk do të mbahen, fjalën e ka gjykata

Ministri Bytyqi pikërisht në mbrëmjen e ditës kur priti në vizitë drejtoreshën...(faqe 8)

Një arritje e madhe e SBASHK, një fitore për të gjithë



Urime ligji i shumëpritur për punëtorët e arsimit të viteve të 90-ta ... (faqe 7)



Fragmente nga bashkëbisedat znj. Suzan Flocken në takimet me SBASHK dhe institucionet ... (faqe 3)

SBASHK-u veprim sipas zërit të anëtarësisë

U dorëzua në Gjykatën Themelore të Prishtinës Padi-ankesa ndaj vendimit të MASHT



Përkrahje e vazhdueshme nga ETUCE dhe shumë sindikata simotra

Komiteti Evropian i Sindikatave për Arsim (ETUCE), ka ripërsëritur mbështetjen për SBASHK-un...(faqe 8)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Marsi një muaj i veçantë për të gjithë ne



Sa herë vjen muaji mars njeriu spontanisht nis e kujton vargjet e këngës “Sërish vjen marsi” dhe me një dhembje krenare kujton ngjarjet e ndodhura në këtë muaj nëpër vite e dekada. Marsi shënoi nisjen e rrugëtimit të popullit për shkëputje nga robëria, marsi shënoi aktin sublim të luftës e sakrificës së familjes Jashari në Prekazin e historisë, marsi shënoi rrugëtimin drejt dritës e kundër errësirës edhe me hapjen e shkollës shqipe. Marsi nëpër vite, dekada e shëkuq shënoi edhe shumë data e ngjarje me rëndësi.

Edhe në këtë mars SBASHK do të organizojë

një manifestim madhështor qendror në Prishtinë për të bërë bashkë e në një festë pishtarët e dijes që janë pensionuar nga prilli i vitit të kaluar e deri në marsin e këtij viti. Do të jetë ky një moment i shpalosjes së kujtimeve nëpër vite duke rrugëtuar bashkë me brezat drejt diturive e arritjeve të reja. Ata do të marrin nga SBASHK si dhuratë domethënëse nga një orë dore që simbolizon kohën e kaluar përball sfidave në kryerjen e misionit të shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave të atdheut dhe nga një mirënjohje shenjë respekti për punën e pakursyer në këtë mision të shenjtë.

Urime të gjithë të punësuarve në sektorin e arsimit dita e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Fragmente nga bashkëbisedat znj. Suzan Flocken në takimet me SBASHK dhe institucionet



Flocken: SBASHK është shembull i mirë i organizimit dhe aktiviteteve sindikale

Suzan Flocken është drejtore e përgjithshme e Internacionales Botërore të Arsimit për Evropën. Me zgjedhjen e saj në këtë post dhe të znj. Kristinë kryetare e ETUCE, SBASHK-u gjeti mbështetje dhe përkrahje të plotë në të gjitha aktivitetet sindikale kudo në Evropë dhe në angazhimet në shërbim të anëtarësisë në Kosovë. Ato në emër të 11 milionë sindikalistëve të arsimit të Evropës shprehen përkrahje të fuqishme për SBASHK-un edhe gjatë grevës 3 javore. Këtë mbështetje znj. Suzan Flocken e rikonfirmoi gjatë vizitës dy ditore në Kosovë në takim me Kryeministrin Haradinaj, me Ministrin Bytyqi, me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurteshi, para medieve të Kosovës dhe në takimin solemn me Këshillin Drejtues dhe me kryetarët e niveleve komunale e të Universiteteve. Në këtë numër të gazetës sonë “Arsimimi sot” po sjellim fragmente nga deklaratimet e saj.

Në shenjë të respektit për mysafiren e lartë veprimtarët sindikal Emrush Ahmeti e Avdullah Krasniqi kishin bërë të mundur vizën në Shpellën e

Gadimes, që është nga më interesantet e më të bukurat në Evropë.

- Këto janë pamje mahnitëse dhe jam shumë e lumtur që më keni dhënë mundësinë të shoh gjithë këto pamje magjepse, shprehet znj. Flocken duke para me kureshtje çdo pamje e çdo mrekulli në këtë shpellë.

Me të arritur në Prishtinë hezitua fillimisht t'i tregojmë znj. Flocken për agjendën e ngjeshur duke menduar se, mbase, do të na thoshte se paskemi aranzhuar shumë takime, por me të marr vesh për këtë agjendë ajo na lavdëroi duke shtuar se me kënaqësi do të marr pjesë në to duke dhënë kontribut në bashkëbiseda me institucione e duke treguar për SBASHK-un dhe përkrahjen që ne gëzojmë nga ETUCE.

Kjo mike e madhe e arsimit kudo në botë komunikonte me lehtësi me të tjerët dhe shtronte pyetje në vazhdimësi për çështjet sindikale, aktivitete, arritjet, sfidat, planet për të ardhmen dhe i gëzohej çdo informate e lajmi të mirë për ne.

E qetë dhe me qëndrimin e dinjitetshëm prej një përfaqësueseje të lartë të sindikatave të Evropës ishte edhe në ambientet e MASHT në takim me Ministrin Bytyqi. Ajo në këtë takim shprehu edhe një herë përkrahjen për SBASHK-un dhe tregoi njohuri të shkëlqyera për gjenjen në arsimin kudo në Evropë, pra edhe në Kosovë.

- SBASHK-u është njëra nga sindikatat anëtare te ETUCE dhe ka respektin tonë sepse është sindikatë e organizuar mirë dhe aktive në mbrojtjen e kërkesave të anëtarësisë, ishte shprehur znj. Flocken në këtë takim për të treguar pastaj për gjithë angazhimet e ETUCE në shërbim të arsimit, ruajtjes së figurës së mësuesit dhe për krijimin e kushteve më të mira të punës në shkolla me qëllim të arritjeve edhe më të mëdha.

Kjo mike e madhe e arsimit zhvilloi një bashkëbisedë përmbajtjesore edhe në ambientet e Parlamentit të Kosovës me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim, Ismajl Kurteshi. Znj. Flocken edhe këtu ka përsëritur mbështetjen për SBASHK-un dhe ka folur pastaj për angazhimet e ETUCE . Ajo ka dëgjuar me vëmendje vlerësimet e z. Kurteshi për gjendjen aktuale në arsim dhe për bashkëpunimin e mirë të këtij Komisioni me SBASHK-un.

Një bashkëbisedë e lehtë e miqësore është zhvilluar edhe në ambientet e Qeverisë së Kosovës. Kryeministri Haradinaj ka zhvilluar bisedën me mysafiren gjuhën angleze duke ua përkthyer atë pjesëmarrësve të tjerë në takim. Znj. Flocken është shprehur e lumtur me takimin dhe ka falënderuar Kryeministrin për mikpritjen dhe bisedën përmbajtjesore duke e informuar atë pastaj për vizionin dhe misionin e ETUCE dhe për përkrahjen që ata i kane dhënë e do t'i japin SBASHK-ut në vazhdimësi në përpjekjet për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe në përpjekje për një arsim sa më të mirë.

Për vlerën e unitetit dhe solidaritetit sindikal dhe për qëllim e vizitës në Kosovë dhe për përshtypjet shumë

të mira nga kjo vizitë znj. Flocken i ka deklaruar edhe para medieve në një konferencë shtypi dhe para veprimtarëve sindikal nga e tërë Kosova për t'i përmbledhur ato në intervistën e saj në programin “Mirëmëngjesi Kosovë”

“ ETUCE ka 11 milionë anëtarë dhe qëllimi i vizitës sime këtu, veç tjerash, është që të shprehim nga afër përkrahjen tonë për SBASHK-un dhe t'i përgëzojmë që me mund e sakrificë kanë arritur të ndryshojnë koeficientet për tërë sektorin e arsimit në Ligjin e pagave.

Ne i kemi dërguar letra mbështetëse SBASHK-ut dhe pastaj edhe letra institucioneve me kërkesën që me dialog të realizohen kërkesat e drejta të SBASHK-ut. Ne ishim në mbështetje të SBASHK-ut gjatë gjithë grevës dhe do të jemi pranë tyre gjithmonë . Po ashtu ne i kemi bërë thirrje gjithë sindikatave anëtare kudo nëpër Evropë që të dërgojnë letra mbështetëse për SBASHK-un. Ne me Kryeministrin, Ministrin dhe kryetarin e Komisionit Parlamentar kemi kujtuar se kudo në Evropë duhet shtuar angazhimet e përbashkëta për dialog të sinqertë dhe për arritje sa më të larta në arsim. Arsimi ka rëndësi të madhe për të ardhmen e çdo vendi dhe të Evropës e botës në përgjithësi, është shprehur znj. Flocken në emisionin e mëngjesit në RTK.

Gjatë muajit

Drejtorja e përgjithshme e EI-së për Evropën qëndroi në Kosovë
Vizitë domethënëse dhe shumë e suksesshme



Duke realizuar turneun e vizitave në katër shtete të Ballkanit e për të shprehur nga afër përkrahjen e Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, ka qëndruar dy ditë edhe në Kosovë, drejtorja e përgjithshme e Internacionales Botërore të Arsimit për

Evropën, znj. Suzan Flocken dhe është takuar me udhëheqësit sindikalë të SBASHK-ut dhe përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Kosovës.

Në shenjë të respektit për miken e madhe të arsimit dhe të SBASHK-ut, asaj i është bërë një pritje madhështore. Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë dëshmuar mikpritjen e njohur të popullit tonë duke dalë në kufi të Kosovës për t'i shprehur mirëseardhjen znj. Flocken, e cila po shoqërohej në turneun nëpër shtetet e Ballkanit nga kryetari i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë Nevruz Kaptelli dhe përgjegjësjë për bashkëpunim ndërkombëtar e kësaj sindikate Angjela Lalla.



Veprimtarët sindikal Emrush Ahmeti dhe Avdullah Krasniqi janë kujdesur që mysafirja të shoh nga afër Shpellën e Gadimës, njërën nga mrekullitë natyrore të Kosovës. Traditën e mikpritjes shqiptare e ka dëshmuar edhe ciceroni i Shpellës, i cili me një dije përfekte për çdo pjesë të kësaj bukurie të rallë natyrore shpjegonte për pamjet e mrekulluara që Zoti i ka falë kësaj pjese të Kosovës. Znj. Flocken është ndjerë e nderuar me nismën kaq interesante të vizitës së saj në vendin tonë.

Pas kësaj mysafirët dhe mikpritësit kanë zhvilluar një bashkëbisedë lidhur me aktualitetin në arsimin në kudo në Evropë e veçmas në Kosovë e vendet tjera të Ballkanit.



Ishte shumë dinamike Dita e dytë e vizitës së znj. Flocken një realizimi i mbarë i agjendës ka nisur me një takim mirëseardhjeje në selinë e SBASHK-ut për të vazhduar pastaj me takimin në MASHT me ministrin z. Shyqiri Bytyqi dhe anëtarë të kabinetit të tij.



Drejtorja e përgjithshme e Ei-së për Evropën, znj. Flocken është shprehur se ka ardhur në Kosovë për të

treguar nga afër mbështetjen për SBASHK-un, sindikatë kjo, që si tha znj. Flocken është shumë e organizuar dhe aktive.



Ministri Bytyqi në fjalën përshëndetjes dhe mirëseardhjes i ka treguar mysafirëve për angazhimet dhe objektivat e kësaj ministrie. Me respekt për SBASHK-un në këtë takim ka folur edhe kryetari i SPASH, z. Kaptelli, i cili ka vlerësuar lartë angazhimet, përkushtimin, unitetin dhe arritjet e shumta të SBASHK-ut.

Një moment i veçantë dhe emocionues vizita në Shkollën e Gjelbër.



Drejtorja Fahrie Ratkoceri ka shoqëruar mysafirët për të parë nga afër kabinetet e furnizuara mirë dhe paralelet gjatë mësimit që po zhvillohej këtu. Znj. Flocken ka bashkëbiseduar me mësimdhënësin e historisë dhe me nxënësit e një paraleleje për të shprehur respektin për gjithë ata dhe për t'i përgëzuar për punën dhe arritjet. Mbresëlënëse ka qenë edhe takimi me mësimdhënësit e kësaj shkolle në pushimin e gjatë mes dy orëve mësimore. Agjenda e kësaj dite sa kishte filluar. Puna, përkushtimi dhe angazhimi i drejtores Ratkoceri dhe i të gjithë të punësuarve në

këtë institucion edukativ e arsimor ka bërë që kjo vatër e dijes të ketë ambiente të këndshme pune dhe arritje e suksese të larta.

Takimet vazhduan në ambientet e Parlamentit dhe të Qeverisë



Agjenda e vizitave dhe takimeve ka vazhduar dhe znj. Flocken me shoqëruesit e saj janë gjendur në ambientet e Parlamentit të Kosovës në një takim domethënës me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim, z. Ismajl Kurteshi, i cili duke shprehur kënaqësinë për këtë vizitë ka shpalosur në bashkëbisedë me mysafiren e lartë angazhimet, por edhe shqetësimet që Komisioni Parlamentar për Arsim ka në agjendën e punës. Kryetari z.Kurteshi ka lavdëruar angazhimin dhe përkushtimin e SBASHK-ut duke kërkuar që të vazhdohet me bashkëpunimin në shërbim të arsimit dhe ngritjes së vazhdueshme të cilësisë.



Takimi me Kryeministrin Haradinaj



Një takim tjetër tepër i rëndësishëm i znj.Suzan ishte edhe ai me Kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, i cili duke dëshmuar mikpritjen, si vlerë të lartë të popullit tonë, ka zhvilluar një bashkëbisedë miqësore me znj. Suzan duke i treguar asaj për përkushtimin e tij dhe të Qeverisë që ai drejton për të mbështetur sa më shumë arsimin në Kosovë, si sektor tepër me rëndësi e në përpjekje për një arsim sa më cilësor.



Drejtorja e përgjithshme e EI-së për Evropën ka falënderuar Kryeministrin për mikpritjen dhe pastaj është shprehur se SBASHK-u vlerësohet lartë nga ETUCE dhe gëzon vazhdimisht mbështetjen dhe solidaritetin e 11 milionë anëtarëve të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës. Ajo pastaj ka shpalosur edhe angazhimet e shumta dhe objektivat e qarta që ka ETUCE në shërbim të arsimit dhe mbrojtjes së kërkesave të anëtarësisë. Në këtë takim ka marrë pjesë edhe Ministri Bytyqi dhe anëtarë të Kabinetit të Kryeministrit Haradinaj .

Takimi me mediet dhe intervista në RTK



Në konferencën për medie kryetari i SBASHK-ut ka treguar për takimet e zhvilluara dhe pastaj ka shprehur falënderimin në emër të anëtarësisë për znj. Flocken dhe për kryetaren e ETUCE, znj. Kristinë, të cilat, siç tha kryetari Jasharaj, kanë ndihmuar shumë SBASHK-un duke i mundur pjesëmarrjen aktive në të gjitha aktivitetet sindikale që zhvilloh ETUCE. Drejtorja e përgjithshme e Internacionales Botërore të Arsimit ka shpjeguar para medieve për arsyen e vizitës në Kosovë duke përsëritur edhe një herë se ETUCE çmon lartë

angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut dhe se kjo sindikatë do të ketë vazhdimisht mbështetjen morale të ETUCE, gjegjësisht të gjithë sindikatave të arsimit të Evropës dhe botës.



Pas takimit me mediet znj. Flocken bashkë me kryetarin e SPASH-it z. Kaptelli dhe atë të SBASHK-ut Jasharaj u janë drejtuar me fjalë përshëndetëse pjesëmarrësve në takimin solemn të organizuar në shenjë respektit të lartë për mysafiren e nderuar.

Kryetari Jasharaj është shprehur se SBASHK-u ndjehet i nderuar për vizitën e mikes së madhe të arsimit dhe pastaj ka shpalosur angazhimet, arritjet, por edhe sfidat me të cilat është përballur kjo sindikatë. Drejtorja e përgjithshme Flocken ka shprehur respektin e lartë për SBASHK-un dhe falënderimin për mikpritjen dhe organizimin kaq të mirë të agjendës së kësaj vizite. Ajo pastaj ka treguar për aktivitetet e shumta dhe objektivat që ka ETUCE duke apeluar te pjesëmarrësit që ta punojnë pa u ndalur në ruajtje të unitetit sindikal dhe në kryerjen e misionit të shenjtë në edukimin e arsimimin e brezave.

Kryetari i SPASH –it, z. Kaptelli edhe në këtë takim solemn ka lavdëruar SBASHK-un për arritjet e shumta dhe ka apeluar që të ruhet me kujdes unitetit kaq i lartë e shembullor i kësaj sindikate.



Pas kësaj shumë nga pjesëmarrësit e takimit solemn kanë falënderuar mysafiren e nderuar për vizitën domethënëse dhe për gjithë mbështetjen që ajo dhe udhëheqës të tjerë të lartë të ETUCE i kanë dhënë SBASHK-ut, e veçmas për mbështetjen dhe letrat e dërguara institucioneve gjatë grevës trejavëshe të SBASHK-ut. Drejtorja e përgjithshme znj. Flocken ka qenë mysafire edhe në programin e mëngjesit të RTK, për t'u përgjigjur në shumë pyetje, që lidheshin me vizitën, por edhe me angazhimet dhe aktivitetet e ETUCE.

Mysafirja e lartë para se të largohej nga Prishtina është shprehur se ndjehet e lumtur me këtë vizitë dhe ka falënderuar e lavdëruar SBASHK-un për pritjen dhe për përkushtimin që kjo vizitë të jetë kaq e suksesshme.

Një arritje e madhe e SBASHK, një fitore për të gjithë

Urime ligji i shumëpritur për punëtorët e arsimit të viteve të 90-ta



SINDIKATA E BASHKUAR E ARSIMIT, SHKENCËS DHE KULTURËS

Rrugëtimi i gjatë i projektligjit për statutin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta mori fund pasi që në seancën e Parlamentit të Kosovës të 71 deputetët e pranishëm votuan për të.

SBASHK-u e vlerëson lartë këtë moment duke e konsideruar si ditë historike datën që u votua Ligji që për vitet e ndritura të arsimit tonë. SBASHK-u përgëzon gjithë të punësuarit në arsim që ishin në mbështetje të fuqishme të udhëheqësve

sindikal në përpjekjet, jo të lehta, e plot 5 vite deri sa erdhi momenti i gëzuar i votimit të këtij Ligji.

SBASHK-u falënderon kryeministrin Haradinaj, kryetarin, nënkryetaren dhe anëtarët e Komisionit Parlamentar për Arsim, Ministrin Hamza, që u kujdes të sigurohen mjetet për Ligjin, Ministrin Reçica për kontributin e dhënë dhe Ministrin Bytyqi për angazhimet rreth këtij ligji me vlerë.

Kujtojmë se përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë pasur debate të nxehta e palët tjera sa herë është debatuar për këtë Projektligj ngase kishte edhe zëra kundër këtij

ligji. Këtë angazhim të pandërprerë këta përfaqësues e bënin në shenjë kujtimi e respekt për gjithë ata që punuan në ato vite të vështira dhe mbajtën të gjatë shpresën për të ardhmen e Kosovës në liri. Po të mos ishte qëndresa sublime e njerëzve të dijes në ato vite atëherë errësira do të triumfonte mbi dritën dhe do të shuheshin shpresat për ardhmërinë.

Faktin se tani më njerëzit e dijes së viteve 90-ta kanë ligjin e tyre SBASHK e konsideron si njërën

nga arritjet e mëdha dhe si dëshmi se kur punohet pa u ndalur e me përkushtim dhe kur me zemër ruhet kujtimi për njerëzit e viteve të ndritura të arsimit, kur veprohet me unitet dhe ruhet kjo vlerë, atëherë suksesi nuk mungon.

Gëzuar të gjithë anëtarëve të SBASHK-ut kjo arritje madhe e përbashkët.

Këshilli Drejtues në takimin e jashtëzakonshëm solli vendim

Orët e humbura në grevë nuk do të mbahen, fjalën e ka gjykata



Ministri Bytyqi pikërisht në mbrëmjen e ditës kur priti në vizitë drejtoreshën e përgjithshme të EI-së për Evropën, znj. Flocken bashkë me delegacionin e SBASHK-ut, pa bashkëbiseduar fare lidhur me çështjen e orëve të humbura gjatë grevës, doli me një vendim të pa bazuar në ligj lidhur me këtë çështje. Kjo ka bërë që Këshilli Drejtues i SBASHK-ut bashkë me kryetarët e Kuvendeve të Sindikatave komunale të Arsimit Parauniversitar dhe të Universiteteve të mbaj takim të jashtëzakonshëm. Në këtë takim u debatua lidhur me deklarin dhe qëndrimin e anëtarësisë rreth çështjes së orëve të humbura gjatë grevës e sidomos rreth vendimit nr. 911, të datës 27 shkurt 2019, të Ministrit Bytyqi lidhur me këtë çështje.



Pas një debati të hapur e duke sjellë mendimin e anëtarësisë Këshilli Drejtues solli vendimin që vendimi nr. 911, të datës 27 shkurt 2019 i Ministrit Bytyqi për kompensimin e orëve të humbura gjatë grevës, të kontestohet dhe të dërgohet në gjykatën gjegjëse me kërkesën për pezullimin e tij dhe deri në vendimin meritor të gjykatës lidhur me këtë çështje orët e humbura gjatë grevës nuk do të zëvendësohen.

SBASHK-u i bindur se MASHT dhe Drejtoritë Arsimore respektojnë institucionet e drejtësisë apelon te këto dy institucione arsimore që presin deri në vendimin meritor të gjykatës lidhur me këtë çështje.

SBASHK-u veproi sipas zërit të anëtarësisë

U dorëzua në Gjykatën Themelore të Prishtinës Padi-ankesa ndaj vendimit të MASHT

Duke u bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues SBASHK-u ka përgatitur dhe ka dorëzuar në Divizionin Administrativ të Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë Padi-ankesën për vlerësimin e ligjshmërisë së kaktit administrativ, vendimit nr. 911, të datës 27 shkurt

2019 i Ministrit Bytyqi, me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi deri në vendimin e gjykatës lidhur me këtë çështje. Ky veprim i SBASHK-ut është përcjellë edhe nga mediet.

SBASHK-u me këtë rast apelon te Drejtoritë Arsimore në të gjitha komunat e Kosovës që të presin

se çfarë do të thotë e si do të veprojnë gjykata e të mos insistojnë e të mos bëjnë presion mbi drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit lidhur me mbajtjen e orëve të humbura gjatë grevës sepse kështu edhe ata mund të përballen me gjykatat.



SBASHK në kongresin e sindikatës turke te arsimit "EGITIM-BIR-SEN" Takime të shumta me sindikata simotra nga e tërë bota



Në Kongresin 6 zgjedhor të sindikatës më të madhe turke të arsimit, Egitim-Bir-Sen, që numëron më shumë se 400.000 anëtarë ka marrë pjesë edhe një delegacion i SBASHK-ut mes 30 delegacioneve nga shtete të Ballkanit dhe botës. Një ditë para se të niste punimet Kongresi, kryetari i “Egitim –Bir –Sen” dhe i Konfederatës “Memur –Sen” është takur me të 30 delegacionet mysafire për t’ju dëshiruar mirëseardhje e për t’i njoftuar me aktivitetet që sindikata që ai drejton ka zhvilluar në vazhdimësi dhe p-ër përgatitjet e shumta që janë bërë për një Kongres sa më të suksesshëm. Këtë ditë edhe delegacioni i SBASHK-ut dhe ai i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë kanë pasur shumë takime me sindikatat simotra nga Maqedonia, Kroacia, por edhe nga vendet tjera të Ballkanit dhe botës duke bashkëbiseduar për sfidat e shumta. Shumë nga këto delegacione kanë përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet dhe për grevën, që dëshmoi unitet të shkëlqyer të anëtarësisë.

Kongresi ka nisur punimet në ambientet e Hotelit "ELIZA" me pjesëmarrjen e qindra delegatëve nga e tërë Turqia dhe të 200 mysafirëve. Fillimisht para tyre dhe mysafire te shumte është shfaqur dokumentari qe pasqyronte aktivitetet dhe sfidat shumta te kësaj sindikate neper vite.



Pas kësaj kryetari i EGITIM- BIR- SEN Ali Jalcin, ka shpalosur raportin e punës duke rikujtuar shume aktivitete sindikale për te vlerësuar larte rolin e kësaj sindikate ne rrjedhat shoqërore ne Turqi, pa harruar edhe aktivitetet humanitare dhe takimet e trajnimet sindikale me anëtarësinë. Fjala e tij është shoqëruar me duartrokitje te gjata te delegateve.



Kongresin e EGITIM BIR SEN ishte parapare ta përshëndeste edhe presidenti i Kongresin e ka përshëndetur njeriu i dytë i Turqisë Fuat Oktay. Ai është shprehur se shteti turk ka bërë shumë për arsimin duke pajisur institucionet me gjithë mjetet e duhura mësimore për të qenë në hap me zhvillimet e për t’i përcjellë zhvillimit e hovshme teknologjike dhe kërkesat e shekullit 21.

Kongresit i kanë dëshiruar suksese edhe përfaqësues të




lartë të sindikatave e konfederatave turke. Po ashtu i është dhënë hapësirë e duhur edhe delegacioneve mysafire të cilat në emër të sindikatave dhe shteteve që përfaqësonin kanë përshëndetur mikpritësin dhe Kongresit i kanë dëshirurë rrjedhë të mabrë të punës. Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, në fjalën e tij përshëndetëse është shprehur se po sjellë përshëndetjet më të sinqerta për kolegët sindikalistë turk prej kolegëve të tyre nga Kosova me urimin që kongresi të arrij sukseset dhe objektivat e pritura në shërbim të anëtarësisë." Ju përshëndes në emër të gjithë të punësuarve në arsimin e Kosovës, të cilët me

përkushtim, grevë, dialog e sakrificë e mbrojtën figurën e mësuesit dhe të punësuarve tjerë në arsim të cilët tentuan ta zbehin institucionet me ligjin për paga".



Duke vazhduar me angazhimet në shërbim të anëtarësisë

SBASHK tani ka 5 programe të licencuara të trajnimeve



SBASHK në konsultim me kryetarët e niveleve sindikale komunale do të nis me parapërgatitjet për të nisur me këto 3 trajnime të aprovuara rishtazi nga Këshilli Shtetëror i Licencimit, gjegjësisht MASHT, por do të vazhdojë edhe me dy trajnimet e më hershme , të cilat janë mbajtur në shumë komuna dhe me një numër të madh anëtarësh të SBASHK-ut. Me këto angazhime të reja SBASHK-u do të jetë afër anëtarësisë dhe do t'i ndihmojë ata që të arrijnë dituri të reja dhe të arrijnë numrin e kërkuar të orëve të trajnimeve për licencën bazë, por edhe për të pasur parakushtet për procesin e gradimeve. Vlen të

theksohet se deri tani SBASHK-u ka organizuar trajnime me programet e licencuara "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social" dhe "Udhëheqja dhe planifikimi strategjik në Arsimin Parauniversitar", që janë trajnime plotësuese. Mirëpo tani e tutje e pas përgatitjeve të duhura do të fillohet edhe me trajnimet bazike e të licencuara: " Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie", "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për ciklin fillor dhe të mesëm" dhe "Edukimi media dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik".

SBASHK vazhdon me aktivitete edhe në ditët e vikendit

Dy grupe trajnimi në Prishtinë, e 6 në Vushtrri

Anëtarët e SBASHK-ut kanë shprehur interesim të madh për trajnimet. Ky interesim është të gjitha

komunat. Kjo ka bërë që vetëm në Vushtrri të punojnë 6 grupe të ndara në institucione të ndryshme arsimore



të kësaj komune. Po ashtu në këtë vikend ka vazhduar trajnimi edhe me dy grupe në Prishtinë. Këtë aktivitet SBASHK e ka intensifikuar me qëllim që t'u dilet në ndihmë anëtarësisë që të arrijnë numrin e duhur të orëve të trajnimeve që kërkohen për licencën e karrierës, por edhe për të krijuar mundësinë që mësimdhënësit të jenë sa më të përgatitur për procesin e paralajmëruar të gradimeve.



Pjesëmarrësit në trajnime gjatë këtij vikendi i ka vizituar kryetari i SBASHK bashkë me menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe me nënkryetarin e BSPK-së, prof. dr. Atdhe Hykolli e kryetarin për Prishtinën, Ahmet Pllana dhe kryetari i sindikatës sonë për Vushtrinë Alush Maloku. Ata kanë biseduar me pjesëmarrësit e trajnimeve dhe fillimisht kanë përgëzuar për angazhimin tranerët Besa Krasniqi, Blendor Shatri, Ramadan Gashi, Safet Beqiri, Alban Zeneli e Besim Haliti.



Në bashkëbisedat me anëtarët e SBASHK-ut që po merrnin pjesë në këto trajnime është folur lidhur me aktualitetin në arsim, për shqetësimet eventuale dhe për idetë e shumta të angazhimit e aktiviteteve të SBASHK në të ardhmen. Pjesëmarrësit në këto trajnime kanë përgëzuar SBASHK-un për angazhimet dhe arritjet dhe kanë kërkuar që të niset sa më parë edhe me tri trajnimet bazike, të cilat janë licencuar falë angazhimit të SBASHK e me qëllim që anëtarësisë t'i ndihmohet në arritjen e sas më shumë orëve të kërkuara për licencim.



Ky interesim kaq i madh i anëtarësisë për trajnime shton volumin e angazhimeve SBASHK me qëllim që ky aktivitet në zhvillohet edhe në komunat tjera të Kosovës pas përgatitjeve që duhet bërë niveli komunal sindikal.

